

NDIHMA JURIDIKE FALAS: QASJE NË DREJTËSI PËR TË GJITHË





Ndihma juridike falas duhet t'u ofrohet atyre që nuk kanë burime të mjaftueshme financiare dhe nëse një ndihmë e tillë është e nevojshme për ta për të siguruar qasje efektive në drejtësi.

Kushtetuta e Kosovës, neni 30 ”



NDIHMJA JURIDIKE | PRAVNA POMOC
LEGAL AID



Agjencia për Ndhimë Juridike Falas është institucioni më i rëndësishëm në sistemin e integruar të ndihmës juridike në drejtim të ofrimit të ndihmës juridike falas. Ekzistojnë tri kategori bazë të kriterëve që duhet të plotësohen për të realizuar të drejtën e ndihmës juridike falas.



kriteri i përshtatshmërisë

u ipet personave që banojnë në territorin e Kosovës dhe personave me qëndrim të përkohshëm në Kosovë.



kriteri financiar

u ipet personave që ushtrojnë të drejtën e ndihmës sociale dhe atyre që të ardhurat totale familjare janë më të ulëta se mesatarja.



kriteri ligjor

ndihma ofrohet duke vlerësuar meritat e çështjes, siç është vlera reale dhe forca e argumenteve.



Në raste emergjente, ndihma juridike falas u ofrohet të gjithë personave të ndaluar apo të arrestuar, pavarësisht nëse i plotësojnë kriteret e parashikuara në këtë ligj.

Agjencia e Ndhmës Juridike Falas ofron shërbime ligjore profesionale përmes:

- Informata ligjore dhe këshillim ligjor në lidhje me procedurat ligjore;
- shkrimin dhe të gjithë mbështetjen tjetër teknike lidhur me përfundimin e çështjes;
- përfaqësimi në procedurë civile, administrative, kundërvajtëse dhe penale;
- mbrojtja dhe përfaqësimi në të gjitha fazat e procedurës penale;
- Informata dhe këshilla ligjore në lidhje me procedurat e kundërvajtjes;
- Informata, këshillim juridik dhe ndihmë në ndërmjetësim, arbitrazh.



Përfituesi i ndihmës juridike falas ka të drejtën e ndihmës juridike falas të garantuar në përputhje me ligjin, pavarësisht nga origjina e tij/saj kombëtare dhe etnike, raca, ngjyra e lëkurës, gjuha, përkatësia fetare ose politike, gjinia, orientimi seksual, gjendja shëndetësore, paaftësia, shtetësia ose vendbanimi.



Agjencia për ndihmë juridike falas është e përkushtuar t'u shërbejë të gjithë atyre që plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj për ofrimin e ndihmës juridike falas, veçanërisht me parimet e drejtësisë dhe sundimit të ligjit.

Ndihma juridike falas nuk është vetëm çështje e qasjes në drejtësi, por edhe një vlerë themelore në një shoqëri të bazuar në shtetin e së drejtës. Duke ofruar mbështetje për ata që kanë nevojë, ndihma juridike falas kontribuon në fuqizimin e barazisë para ligjit dhe siguron që sistemi ligjor të funksionojë në mënyrë të drejtë dhe transparente për të gjithë qytetarët.

Kontakt

Zyra qendrore e Agjencisë për
Ndihmë Juridike Falas



Rr. "Zenel Salihu" nr.30



038 200 18 942



www.anjf.rks-gov.net



0800 11 777

